

Njoftim për shtyp 20 Shkurt 2020

Sot më datë 20.02.2020, Këshilli zhvilloi mbledhjen e radhës në të cilën miratoi detajimin e buxhetit për vitin 2020 për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemin gjyqësor në tërësi.

Në vijim Këshilli miratoi, kërkesat e disa gjykatave për nxjerrjen jashtë përdorimit të një grupi asetesh të amortizuara, në pronësi të tyre.

Gjithashtu Këshilli me qëllim rivënien në funksion të Gjykatës së Apelit Korçë, në kushtet kur kanë mbetur vetëm dy gjyqtarë, vendosi komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. Mimoza Margjeka dhe caktimin e saj pranë kësaj gjykate deri më datë 15.09.2020.

Në përfundim Këshilli vendosi caktimin e gjyqtarëve në disa gjykata të vendit për gjykimin e çështjeve të caktuara, me qëllim kryesor dhënien e drejtësisë në kohë ndaj qytetarëve.